



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:030011

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05630000

KPPP.nr.1808/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit NP “Medruplast”, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shpend Bokshi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Inter-Eminex” SH.P.K., me seli në rr. “Zona Industriale” në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit Përmbarimor E.nr.701/14 të datës 23.05.2014, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, jashtë seancës, me datën 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Inter-Eminex” SH.P.K., dhe aktvendimi përmbarimor E.nr.701/14 i datës 23.05.2014, i lejuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Auto Llapi” SH.P.K., ka caktuar aktvendimin për përmbarim E.nr.701/14 të datës 23.05.2014, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 12-210-001-4086 të datës 19.11.2012, Faturës Nr. 12-210-0001-4550 të datës 22.12.2012 dhe Faturës Nr. 13-210-001-681 të datës 19.02.2013, me të cilin ka urdhëruar debitorin që të paguaj shumën prej 1,309.39 €, me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së propozimit e deri në ditën e pagesës definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në shumën prej 144.00 €, ashtu që përmbarimi do të kryhet duke i urdhëruar bankat komerciale në Kosovë deri në realizimin e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi aktvendimin E.nr.701/14 të datës 23.05.2014 dhe se gjykata e çështjes ka gabuar kur e ka lejuar propozimin dhe e ka detyruar debitorin që të paguaj kamatën vjetore prej 8%, ngase dispozitat ligjore në fuqi e lejojnë kamatën vjetore 3.5%. Më tutje ka shtuar se palët në këtë procedurë janë në marrëdhënie afariste për më shumë se dhjetë vite dhe se debitori është në gatishmëri që këtë çështje ta zgjedhin në rrugë jashtëgjyqësore, po që se ekziston vullneti i kreditorit. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi i ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë E.nr.701/14 i datës 23.05.2014 të anulohet.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në faturat e lartcekura, në bazë të së cilave është mbështetur propozimi për përmbarim gjeti se të njëjtat janë bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit, e rrjedhimisht propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me nenin 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbaremore origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*

Bazuar në dispozitën e sipërcituar, gjykata gjeti se në rastin konkret aktvendimi përmbarimor E.nr.701/14 i datës 23.05.2014, është nxjerrë pa plotësimin e kushteve për lejimin e përmbarimit, ngase propozimi për përmbarim bazohet në një dokument kopje dhe si i tillë përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar aktvendimi për përmbarim si dhe ligjshmërinë e këtij aktvendimi përmbarimor.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktvendimit për përmbarim, ndërsa organi përmbarues - gjykata, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi aktvendimin përmbarimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43, nenit 71 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1808/23, datë 26.04.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.